



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 11.09.2012, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi-OSBE; Nevahir Hazeri-KDI; Visar Bivolaku-EU OFFICE-EUSR; Nuredin Ibishi- CDF; Burim Tahiri dhe Florije Kryeziu-UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Marrja e vendimit të Komisionit për ndjekje të trajnimeve për kontrollet financiare;
3. Njoftimi i grupit të punës lidhur me vizitën në burgun e Dubravës;
4. Shqyrtimi i shkresës së Avokatit të Popullit lidhur me pakënaqësitë rreth punës së menaxherit të Administratës Tatimore të Zyrës Rajonale të Mitrovicës;
5. Shqyrtimi i dy kërkesave të qytetarëve;
6. Të ndryshme.

Pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, kryetarja kërkoi nga Komisioni që të fillohet sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2 Marrja e vendimit të Komisionit për ndjekjen e trajnimeve për kontrollet financiare

Kryetarja – I njoftoi me kërkesën e OSBE – së lidhur me ndjekjen e trajnimit, i cili do të mbështetet nga OSBE - ja. Ajo tha se OSBE -ja e ka angazhuar një ekspert ndërkombëtar që do t'i ofrojë eksperiencë Komisionit për mbikëqyrjen financiare të buxhetit të Komisioneve si dhe agjencive që mbulon ky Komision. Në fund, pasi e njoftoi me përmbajtjen e trajnimit, u kërkoi anëtarëve të Komisionin që të shprehin mendimin lidhur me këtë trajnim dhe lidhur me këtë i ftoi që të marrin fjalën.

Kurtan Kajtazi – Lidhur me kërkesën nga ana e OSBE-së, që ka të bëjë me trajnimin, theksoi se kjo nuk bie në fushëveprimin e Komisionit dhe nuk është punë e tij që të shqyrtojë raporte financiare të ndryshme.

Kymete Bajraktari – Duke u ndërlidhur me kërkesën për organizimin e një trajnimi të tillë, theksoi se do të ishte e dëshirueshme mbajtja e një trajnimi. Ajo personalisht ka kërkuar që të bëhet një trajnim lidhur me mbikëqyrjen financiare.

Pas një debati konstruktiv që u zhvillua lidhur me këtë pikë, Komisioni nxori këtë

P E R F U N D I M

Komisioni e mbështeti kërkesën e OSBE-së për organizimin e trajnimit lidhur me mbikëqyrjen financiare dhe i dha mbështetje që të marrë të gjitha veprimet rreth ofrimit të mbështetjes teknike lidhur me trajnimin.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së trajnimit, Komisioni do të informohet me kohë nga ana e organizatorit.

3 . Njoftim i Komisionit lidhur me vizitën e grupit të punës në Burgun e Dubravës

Kryetarja – Në pika të shkurtra, i njoftoi anëtarët me ngjarjen që ka ndodhur në burgun e Dubravës, që ka të bëjë me grevën e të burgosurve, prandaj ftoi grupin e punës që të marrë fjalën dhe të informojë Komisionin në pika të shkurtra lidhur me të gjeturat e tij gjatë vizitës në burgun e Dubravës.

Albana Gashi – Theksoi se informacionin lidhur me grevën e kishte marrë nga familjarët e të burgosurve, të cilët kanë informuar se të burgosurit kanë hyrë në grevë të urisë. Ajo tha se grupi prej 4 anëtarëve të Komisionit, më 4 shtator 2012, ka vizituar burgun e Dubravës dhe janë takuar me këshillin drejtues të burgut, si dhe me të burgosurit. Grupi i punës është njoftuar me kërkesat e të burgosurve të cilat ishin: futja e institutit të

amnistisë si kategori kushtetuese dhe në bazë të saj të hartohet Projektligji për amnistinë, i cili më vonë do të bëhet miratimi i tij nga ana e Kuvendit të Kosovës. Pasi njoftoi lidhur me gjendjen e grevistëve në pavijonet e burgut që ishin përfshirë në grevë urie, i kërkoi Komisionit informim lidhur me përgjigjen e Gjykatës Kushtetuese, që ka të bëjë me Institutin e Amnistisë. Ajo i kërkoi Komisionit që lidhur me këtë të nxjerrë rekomandim dhe të njoftohet Kuvendi i Kosovës.

Kryetarja – U pajtua me kërkesën e parafolëses që Komisioni të nxjerrë një rekomandim, me të cilin do të kërkohet që të përfshihet Instituti i Amnistisë si kategori kushtetuese, ndërsa më pas të miratohet Ligji për amnistinë.

Kurtan Kajtazi – Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, i kërkoi Komisionit që t’u apelojë të burgosurve për ta ndërprerë grevën, meqë sipas tij, lënda është proceduar në Gjykatës Kushtetuese, ndërsa sa i përket çështjes së amendamentimit të Kushtetutës lidhur me Amnistinë, nuk ka arsye që të burgosurit të vazhdojnë grevën.

Kryetarja – I kërkoi Komisionit që t’i drejtohet me rekomandim Kryesisë së Kuvendit, në mënyrë që sa më shpejt të zgjidhet çështja e lartpërmendur.

Rita Hajzeraj – Beqaj – E informoi Komisionin lidhur me vizitën që u kanë bërë të burgosurve, të cilët kishin hyrë në grevë në burgun e Dubravës dhe janë qartësuar shumë gjera lidhur me motivin e grevës së të burgosurve, meqë sipas saj, ka pasur mendime të ndryshme. Ajo kërkoi nga Komisioni që sërish të vizitohen të burgosurit lidhur me informimin e shkaqeve të futjes së amnistisë si kategori.

Kurtan Kajtazi – Sërish i rekomandoi Komisionit që të lusë të burgosurit për ndërprerjen e grevës.

Më pas, lidhur me këtë pikë diskutuan deputetët: Suzan Novoberdali, Kimete Bajraktari, Kurtan Kajtazi, që ishin të mendimit për ndërprerjen e grevës dhe njëkohësisht të informohen rreth veprimeve të ndërmarra nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës se çka ka ndërmarrë, e pastaj Komisioni të dalë me rekomandime, ndërsa në fund të vendosë se a do t’i vizitojë të burgosurit apo jo.

Kimete Bytyçi – Ishte e mendimit që Komisioni të dalë me rekomandim, i cili do t’i procedohet Kryesisë së Kuvendit, sesa t’u drejtohem të burgosurve për ndërprerjen e grevës, ngase nuk kemi ofruar gjëra konkrete në raport me grevistët.

Komisioni, pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me grevën e të burgosurve, hodhi në votim propozimin e deputetit Kurtan Kajtazi që ka të bëjë me ndërprerjen e grevës dhe më pas nxori këtë:

Përfundim

Komisioni u bëri thirrje të burgosurve, të cilët kanë hyrë në grevë urie në burgun e Dubravës, që të ndërprejnë grevën e urisë dhe gjithashtu Komisioni u zotua që të marrë

informacione lidhur me përgjigjen e shkresave drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, rreth veprimeve të ndërmarra për lejimin e Ligjit për amnisti.

4 Shqyrtimi i shkresës së Avokatit të Popullit lidhur me pakënaqësitë rreth punës së menaxherit të Administratës Tatimore të Zyrës Rajonale të Mitrovicës

Suzan Novoberdali – E njoftoi Komisionin me shkresën e Avokati të Popullit dhe tha se edhe ministri i Financave është i njoftuar lidhur me një mosmarrëveshje që ka ndodhur ndërmjet menaxherit të Administratës Tatimore në Mitrovicë dhe përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, të Zyrës Rajonale në Mitrovicë.

Rita Hajzeraj Beqaj – Në cilësi të raportueses, ishte e mendimit që të ftohen të dy palët dhe të dëgjohen, sepse mund të ketë perceptime të ndryshme rreth realitetit.

Lidhur me këtë çështje, diskutuan deputetët: Albana Gashi Kurtan Kajtazi, si dhe Suzan Novoberdali, kryetare.

Ishte mendim i përgjithshëm se kërkesa e cila i është adresuar Komisionit, më tepër ka karakter informativ, sesa obligues, prandaj me këtë shkresë është i njoftuar edhe ministri i Financave, z. Bedri Hamza.

5. Shqyrtimi i disa kërkesave

Rita Hajzeraj Beqaj – Në cilësi të raportueses, njoftoi Komisionin me përmbajtjen e kërkesës së kompanisë së thëngjillit në Kastriot dhe shtoi se kompania ka kërkuar nga Bordi i KEK–ut, që kontrata t’i zgjatet edhe për 5 vite, me qëllim të bartjes së thëngjillit për nevojat e popullit.

Komisioni, pas një debati që zhvilloi lidhur me kërkesën në fjalë, unanimisht nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione konsideron se shkresa e adresuar nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj u rekomandon ankuesve që t’i drejtohen gjykatës kompetente rreth ndërprerjes së kontratës.

Albana Gashi – Në cilësi të raportueses, e njoftoi Komisionin lidhur me kërkesën e M. LL. i cili ka kërkuar disa herë për lirim nga vuajtja e dënimit. Ajo tha se nuk e kupton veprimin e autoriteteve dhe shkaqet e mosrealizimit të kësaj kërke, pasi qe arsyetimi për moslirim me kusht nuk është bindës.

Lidhur me këtë kërkesë diskutuan edhe Suzan Novoberdali- kryetare dhe Rita Hajzeraj. Pas një debati të gjerë, Komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione konsideron se shkresa e adresuar nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon Mit'hat Llozhanit që shkresën t'ia adresojë Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë për inspektimin e punës së SHKK – së, pasi është në kompetencën e tyre.

Rita Hajzeraj – Beqaj - E njoftoi Komisionin lidhur me kërkesën e Xh. Z. nga Vitia. Ajo theksoi se në kërkesë konsiderohet se i janë shkëlur disa herë të drejtat Xh. Z. nga organet që kanë qenë të obliguara t'i ndihmojnë.

Kryetarja – e njoftoi Xh. Z se është miratuar Ligji për të Verbërit dhe i sugjeroi atij që të anëtarësohet në shoqatën për të verbërit me qëllim të përfitimit të beneficioneve që i garanton ai ligj.

Pas debatit lidhur me këtë kërkesë, Komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione konsideron se kërkesa e adresuar nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon që kërkesën t'ia adresojë Ministrisë së Shëndetësisë, përmes Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

Kryetarja – Njoftoi Komisionin lidhur me ankesën e F. M. nga Gjakova, e cila i është drejtuar Komisionit lidhur me ankesën ndaj Shoqatës “Thirrjet e Nënave” nga Gjakova.

Kurtan Kajtazi – Tha se është mirë që të bëhet apel tek Shoqata “Thirrjet e Nënave” që ta kenë parasysh F. M. dhe ta përkrahin moralisht dhe materialisht.

6. Të ndryshme

Kimete Bytyçi – Në emër të grupit për të drejtat e fëmijëve, ishte e mendimit që javën tjetër të takohen dhe të diskutojnë për çështjet që janë në plan.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali